



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:020068

Datë: 29.05.2018

Numri i dokumentit: 00047727

P.nr.973/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesbajtësit Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit M. N. nga Zh., me numër personal *numri personal...*, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II nr. 945-1/17 , të datës 28.04.2017 në praninë e Prokurorit të Shtetit Besim Susuri, të pandehurit M. N., me datë 29.05.2018 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. N. nga i ati A. e ema K. e lind. O., i lindur me *data e lindjes...* me banim ne fhs. Zh. i pa martuar punëtor ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosoves.

ESHTE FAJTOR

Se me dt.28.03.2017 rreth orës 01.30 min, ne Prizren ne rr. ... me dashje ia marrin pasurinë me qellim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, ne atë mënyrë i pandehuri shkon ne parkingun para banesës se te akzuarit V. Gj., automjeti ishte i hapur dhe çelësat ishin tek kasetofoni, vjedh automjetin e makrës “Opel Kadet” me targa te regjistrimit *numri i targës....*

-këso dore kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 43, 45, 46, 73 dhe 74 të KP te akzuarit i shqipton :

DËNIM ME BURG

Ne kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj – 60 dite .

Dhe

DËNIM ME GJOBË

Ne shume prej 200 (dyqind) euro, te cilën është i obliguar ta paguaj ne afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë ne te kundërtën dënimi me gjobe do ti zëvendësohet me dënim me burg ashtu qe 1 (një) dite burg do ti llogaritet ne shume prej 20 euro.

I dëmtuari V. Gj. nga Prizreni rr.... nr... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Obligohet i pandehuri qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 40 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit mbi kompensimin e viktimave te krimit te akuzuarit i caktohet taksa ne shume prej 30 euro te cilin është i obliguar ta paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore ne Prizren me aktakuzën PP:nr.945/17 te dt.28.04.2017 ndaj te akuzuarit M. N. nga fsh. Zh. për shkak të veprës penale te vjedhjes nga neni 325/1 te KP.

I akuzuari M. N. ne shqyrtimin fillestar , në tërsi e ka pranuar veprën penale e cilas i vihen ne bare sipas aktakuzës , e po ashtu kanë pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi te fajit pranimi eshte i vullnetshëm dhe mbështetet ne faktet e qeshjes qe përmban aktakuza dhe se akuza nuk ka asnjë shkejle te qarte ligjore apo gabime fktike.

Gjyqtari gjykues, pas marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit ka vlerësuar se një pranim i tillë ka mbështetje në provat të cilat i përmban aktakuza , prandaj pranimin e fajsisë e ka aprovuar.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprave penale te vjedhjes nga neni 325 par.1. te KP, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me burg si dhe dënim me gjobë.

Gjatë matjes dhe caktimit te dënimit gjykata aplikoi nenin 73 dhe 74 te KP-së, per te gjetur dhe çmuar faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë ka shpreh , pendimin e thellë për

veprën e kryer, moshën relativisht të re, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë me vepra penale, sjelljen korrektë para gjykatës, si dhe gjendjen e dobët ekonomike, me rastin e matjes së dënimit për gjobën e shqiptuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest civil u marrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPK.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:020068, 29.05.2018

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.